

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS – MALLRA

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

- **Objekti i procedurës:** “Blerja dhe instalimi i Sistemeve VCS (Voice Communication System), VCR (Voice Communication Recorder) për Kullën e Kontrollit në Aeroportin e Vlorës”.
- **Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP):**): 34962000 - 8 Pajisje kontrolli të trafikut ajror ; 48620000 - 0 Sisteme operative.
- **Vlera e fondit limit:** **39 788 800** (tridhjetë e nëntë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e tetëqind) **lekë pa TVSH** ose **403 988** (katërqind e tre mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tetë) **Euro pa TVSH**. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 24/12/2024 është **98.49 Lekë/Euro**.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor ALBCONTROL ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*
- b. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

Argumentimi:

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Nenit 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar.

Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” citohet: “*Autoriteti Kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”, Në Nenin 82, të LPP “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2021,2022,2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në dispozitat e legjislacionit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. VKM-së nr.922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”. Duke marrë në konsideratë specifikën e mallrave objekt procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për tre vitet e fundit financiare të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të balanceve të viteve: 2021, 2022, 2023 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy balance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Janë vendosur kriteret e mësipërme, për të vërtetuar se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën me sukses.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi:

Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar me sukses kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat ose ekuivalentet e tyre, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- **ISO 9001: 2015** “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”
- **ISO 27001:2017** “Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit”

Argumentimi:

Kërkesa në lidhje me këto çertifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” – Ky standard është i nevojshëm për çertifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse shërbimet e ofruar janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve. Çertifikata duhet të jenë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

ISO 27001:2017 “Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit” - është thelbësor, pasi siguron zbatimin e sigurisë së informacionit që kategorizohen në kontratë. Ky lloj çertifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka standardet ndërkombëtare të duhura për menaxhimin e sigurisë së informacionit gjatë zbatimit të kontratës. Çertifikata duhet të jenë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Sqarojmë se Albcontrol, operon në një fushë që është shumë specifike “Navigimi Ajror”, sipas rregullores Europiane dhe të audituar nga ana e Agjensisë Europiane të Sigurisë së aviacionit (EASA) çdo dy vjet, ndërkohe sistemet me të cilët operon duhet të jenë komptibël me kërkesat e rregullatorëve ndërkombëtare të Aviacionit Civil sipas Rregullores së Komisionit Europian si dhe kërkesave të tjera që kanë të bëjnë me sigurinë dhe përputhshmërinë me rregulloret si dhe me sistemet e tjera që janë operative.

Kërkesa për certifikime sipas standardeve ISO janë në vetvete një garanci me teper për suksesin e projektit dhe në lidhje me cilësinë e produktit dhe shërbimeve.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të sigurojë deklaratën e përshtatshmërisë për përdorim sipas rregullores së Parlamentit Evropian dhe Këshillit **EU) 2018/1139**, e transpozuar me VKM nr.1095 datë 24.12.2020 dhe Rregullores së Deleguar të Komisionit (EU) 2023/1768, **Ose** Udhëzimit të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit nr.8 datë 03.06.2010, i rishikuar me Udhëzimin e Minsitrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr.5 datë 15.09.2015”.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të provojnë përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, që është në përputhje me rregullat e Europiane për kryerjen e ketyre shërbimeve si dhe transpozuar në udhëzimin e Ministrit të Transportit dhe Infrastruktures, kapacitetet teknike, ligjore dhe profesionale objekt kontrate janë mbështetur në këto rregullore dhe udhëzime. Albcontrol sh.a, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci teknike dhe ligjore për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për certifikim nga autoritetet përkatëse.

Rregullorja EU) 2018/1139, është transpozuar me VKM nr.1095 datë 24.12.2020 dhe Rregullorja e Deleguar e Komisionit (BE) Nr. 2023/ 1768 do të zbatohet për pajisjet ATM/ANS që mbajnë deklarata KE të lëshuara në përputhje me nenet 5 ose 6 të Rregullores (KE) nr. 552/2004 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe që janë vendosur në operacion përpara datës së hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje. Rregullorja (KE) Nr. 552/2004 “Për Ndërveprimin në Rrjetin Evropian të Menaxhimit të Trafikut Ajror” është përafruar në legjislacionin shqiptar me Udhëzimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit Nr. 8, datë 03.06.2010, i rishikuar me Udhëzimin e Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr.5 datë 15.09.2015”.

2.3.4 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim prodhuesi ose nga distributor i autorizuar për mallrat objekt prokurimi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se paraqitet autorizim distributori duhet të provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit nëpërmjet një dokumenti zyrtar të vlefshëm (kontratë, certifikatë, deklaratë etj).

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në nenin 40, pika 8, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që janë të autorizuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për tregtimin e mallit dhe kryerjen e shërbimeve dhe riparimeve në rast defekti, brenda periudhës së garancisë. Në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor ka garanci që po hyn në marrëdhënie kontraktuale me një operator ekonomik serioz në treg, që ka autorizim për kryerjen e aktivitetit objekt prokurimi dhe siguron lidhjen përkatëse me subjektin që ka dhënë autorizimin.

2.3.5. Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Katalogun/ët teknik për mallrat që do të furnizojë për këte objekt prokurimi në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike. Në katalog, të markohen në mënyrë të qartë dhe të dallueshme mallrat e ofertuara, si edhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në D.T. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike, me qëllim që A.K. të vlerësojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në D.T.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 40, pika 6/b, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. A.K. ka kërkuar katalogët e mallit që do të ofrohet nga O.E. për të vërtetuar se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesa për katalogët e produktit ka rëndësi specifike për këtë procedurë prokurim si dhe specifikimet teknike të produktit për sa i përket proceseve të punës që do kryejnë në veprimtarinë e Albcontrol. Katalogu i produktit lehtëson punën e A.K. për të verifikuar nëse produkti i ofruar nga O.E. plotëson standartet e përcaktuara nga AK në përputhje me përcaktimet e specifikimeve teknike të publikuara në D.T.

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë deklaratë për garancinë e mallit sipas specifikimeve teknike si dhe që mallrat janë brand origjinale (jo të asbluara, jo refurbished, të reja).

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli objekt prokurimi është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të kryhet zëvendësimin ose riparimi i tyre.

2.3.7 Operatorët Ekonomikë duhet të kenë në stafin e tyre;

Minimumi 2 (dy) Inxhinierë elektronikë

Kërkesa e mësipërme duhet të vërtetohet me:

- Kontratë punë përkatëse
- Diplomat përkatëse

- Listëpagesat sipas formatit E-Sig 25, të konfirmuara nga Administrata Tatimore që vërtetojnë se punonjësi ka qenë i punësuar pranë operatorit ekonomik 3 (tre) muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës të procedurës së prokurimit.

-Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

-Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni në fuqi. Mungesa e këtij stafi në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të montimit të pajisjeve. Numri i inxhinierëve elektronikë, të cilët duhet të jenë profesionistë të specializuar në zhvillimin dhe aplikimin e teknologjive dhe sistemeve elektronike, është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e kontratës. Operatorët Ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

-Për të garantuar eksperiencën e stafit të operatorit ekonomik pasi kemi të bëjmë me një procedurë që për Albcontrol sh.a është shumë e rëndësishme është kërkuar prezenca në stafin e operatorit ekonomik për të paktën 3-muaj që është dhe periudha minimale e parashikuar në Kodin e Punës si periudhë prove për një punonjës.

(Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomike ky kriter 2.3.7 plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje, në mbështetje të legjislacionit të sipërcituar).

Shënim: Kjo kërkesë 2.3.7 përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të D.T.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga A.K.

Të gjitha dokumentet duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njësimin e dokumenteve.

I. Argumentimi i Specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktimi i specifikimeve teknike, pjesë e D.T. ngarkuar në S.P.E., për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Njësia e Prokurimit